

**DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË
DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

Nr. _____ Prot

Data 04.09.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Pune

“Rikonstrukcion dhe fuqizimi i N.Stacionit Çorovodë e Re 110/35/10 kV”.

Procedura e Prokurimit e zgjedhur në mbështetje Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020, për “Prokurimin publik”, neni 42 si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik” (i ndryshuar) , Kreu VI, neni 47, është “Procedurë e Hapur”.

Njësia e Prokurimit në mbështetje të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” Neni 41 si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar), Kreu V, “Dokumentet e tenderit”, Seksioni I “Dokumentat Standarte të tenderit” për procedurën e prokurimit **“Procedurë e Hapur”** paraqet dokumentet e tenderit dhe formularët përkatës të hartuara si vijon:

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

- Shtojca 1. Formulari i Ofertës
- Shtojca 2. Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit
- Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës
- Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial
- Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike
- Shtojca 6. Grafiku i realizimit të punimeve
- Shtojca 7: Formularët e Përshtatshmërisë dhe Kualifikimit të Ofertuesve
- Shtojca 8: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit
- Shtojca 9: Formulari i Vlerësimit
- Shtojca 10: Preventivat e Punimeve
- Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.
- Shtojca 12 - Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak)
- Shtojca 13 Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimimit) .
- Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)

- Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimimit) .

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

45232221-7 - Nënstacion transformator.

VLERA E FONDIT LIMIT:

149,998,679.95 (njëqind e dyzet e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e nëntë pikë nëntëdhjetë e pesë) Lekë pa TVSH.

Njësia e Prokurimit hartoi **KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT mbështetur në shtojcën 7 të DST-ve si mëposhtë vijon :**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët

janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Shënim: Në zbatim të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar me VKM-në nr.710, datë 24.11.2021 neni 26/6 me kërkesë të Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë fizikisht pranë Autoritetit Kontraktor, DTL, dokumentacion provues të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Kriteret e përgjithshme janë vendosur në funksion në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 për "Prokurimin Publik" neni 76 dhe Neni 77 si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", (i ndryshuar) kapacitetet ligjore të cilat vërtetojnë se ofertuesit e mundshëm janë të suksesshëm, janë krijuar dhe veprojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi apo legjislacionit të shtetit të origjinës. Në rastin ku oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë kushti i vendosur për mënyrën e paraqitjes së ofertës së tyre është përcaktuar në mbështetje të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin publik", Neni 14 pikat 2 dhe 3 si dhe Kreut XI, Neni 88 "Bashkimi i operatorëve ekonomik" të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar).

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHITETËSE

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

b. Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.3.2 Kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (**2020, 2021, 2022**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se 50% e fondit limit të kontratës që prokurrohet. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2022**, prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” I ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” I ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Kapaciteti teknik:

2.3.4 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

Operatori ekonomik ofertues për të provuar përvojën e mëparshme, duhet të ketë realizuar të paktën:

a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Si dëshmi për përvojën e mëparshme, OE Ofertues duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, OE Ofertues duhet të paraqesë si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt procedure prokurimi, si dhe punimet e kërkuara, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontrata të ngjashme, të jetë sipas parashikimeve ligjore. Në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

Gjithashtu, duke patur në vëmendje punën e vështirë që duhet të bëjë OE në realizimin e kësaj kontrate, pasi duhet të ketë përvojën e nevojshme në nënstacione elektrike, AK kërkon me doemos që OE ofertues t'a ketë një përvojë të ngjashme për ndertime nënstacionesh ose centrale elektrike.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

1. Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve:
1. Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9, shoqëruar me:
2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
3. Situacionin përfundimtar të objektit;
4. Aktin e kolaudimit;
5. Çertifikatën e marrjes në dorëzim;

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

1. Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:
1. Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9, shoqëruar me:
2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
3. Situacionin përfundimtar të objektit;
4. Aktin e kolaudimit;
5. Çertifikatën e marrjes në dorëzim / Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim
6. Fatura tatimore përfundimtare.

Pika 2.3.1 gërma "a" plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”).

2.3.5 Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet, i kualifikuar per keto punime.

Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të jete Ing. Elektrik dhe të deklaroje se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:

1. Librezë pune
2. Kontratë pune e vlefshme
3. Diplomë

Argumentim Së pari, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve në ndërtim, mjedisi, topograf, gjeodet, elektrik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në

mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

2.3.6 Operatori ekonomik (ne baze te VKM 312 Dt.05.05.2010 per miratimin e rregullores per sigurine ne kantier) duhet te kete te pakten 5 (pese) punonjes te trajnuar dhe te pajisur me certifikate te punimeve

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

ne lartesi te leshuara nga shoqeri te licensuara nga ministria perkatese, te cilet te jene te siguruar te pakten per 3 (tre) muajt e fundit.

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:

- i) certifikatat e punonjesve per punimet ne lartesi
- ii) listpagesat E-Sig te punonjesve te sipercituar.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Në lidhje me stafin teknik te certifikuar per punime ne lartesi, argumentohet se realizimi i punimeve objekt kontrate kerkon punonjes qe kane aftesite fizike dhe teknike per te punuar ne kushte te veshitura pune, ne shtylla tensioni te larte dhe ne lartesi nga toka.

Persa i perket kerkeses per nje inxhinier te trajnuar dhe te pajisur me certifikate si pergjegjes per sigurine dhe shendetin ne pune me rrisht te larte, argumentohet se eshte i nevojshem te qendroje ne kantierin e punimeve per te ndjekur ecurine e punes se punonjesve te OE ofertues dhe te jete i gatshem ne rastin e paraqitje se kushteve te rrezikshme qe mund te ndodhin gjate zbatimit te kontrates objekt prokurimi, ne perputhje me Ligjin Nr. 10237, date 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", i ndryshuar.

Keto kërkesa janë në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe pika 6/c, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet te kete fuqi minimale punetore te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit, me nje numer prej mesatarisht **15 punonjës** per 3 muajt e fundit duke marre si reference daten e hapjes se tenderit; te paraqitura dhe te konfirmuara nepermjet formes elektronike nga organet tatimore per periudhen e mesiperme, nga te cilet duhet te kete specialistet si me poshte:

- 5 (pesë) elektrikist/specialist elektrik.
- 5 (pesë) punonjes të kenë kategorine, **e IV ose më e lartë** dhe pjesa tjetere të jenë t pajisur me OMVK për elektrikist.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8. Ndersa operatori ekonomik fitues, para lidhjes se kontrates, duhet te dorezoje dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **Qershor – Gusht 2023**.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Qershor – Gusht 2023**.

Argumentimi: Kjo kërkesë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/ç, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në lidhje me numrin e fuqisë mesatare punëtore të siguruar, duke patur parasysh volumet e punëve objekt kontrate, natyrën dhe vlerën e kontratës, ky numër punonjësish është proporcional dhe i lidhur me aftësinë zbatuese, me qëllim realizimin në kohë dhe me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

2.3.8 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar si drejtues teknik te perfshire ne licencen e shoqerise te pakten 1 (nje) inxhinier ndertimi, 1 (nje) inxhinier mekanik, 1 (nje) inxhinier elektrik, 1 (nje) inxhinier topograf/Gjeodet. Inxhinieret e mesiperm duhet te jene te siguruar dhe te figurojne ne listepagesat perkatese E-Sig per 3 (tre) muajt e fundit.*

- Ing. Gjeodet 1 (nje)
- Ing. Elektrik 1 (nje)
- Ing. Ndertimi 1 (nje)
- Ing Mekanik 1(nje)

Për specialistët e sipercituar sipas profesioneve, duhet të paraqiten CV-të, deshmitë/certifikatat ose cdo dokument tjetër që verteton diplomimin apo kualifikimin e tyre sipas profesionit, si dhe kontratat individuale të punës të vlefshme për të pakten periudhën e parashikuar të zbatimit të punimeve.

- Secili specialistë i sipercituar sipas profesioneve, duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të pakten periudhën **Qershor – Gusht 2023**.

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas pikës 2.4, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin ,stafin mbeshtetes si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NP1**, eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinierit të Ndërtimit**.
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NP 11**, eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinier Elektrik**.
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NS 18** eshte e nevojshme prezenca e një **Inxhinier Gjeodet/Topograf/**, pasi çdo matje që do të bëhet në funksion të objektit të prokurimit kërkon domosdoshmërisht praninë e këtij Inxhinieri.

- Për sa i takon inxhinierëve të ndërtimit të kërkuar, janë të nevojshëm për zbatimin e kontratës pasi inxhinierët e ndërtimit janë ekspertët kryesor për projektimin dhe zbatimin duke patur parasysh natyrën e investimit që do të kryhet.

- Për sa i takon inxhinierit elektrik të kërkuar, është të nevojshëm për zbatimin e kontratës pasi inxhinieri elektrik do të ndjekin ecurinë e punimeve elektrike që nga projektimi deri në zbatimin e plotë të investimit.

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

-Për sa i takon inxhinierit gjeodet të kërkuar, është i nevojshëm për zbatimin e kontratës pasi inxhinieri gjeodet do të jetë pjesë aktive e procesit të projektimit dhe zbatimit të kontratës duke bërë të mundur matjet dhe rilevimet topografike dhe batimetrike të kësaj kontrate specifike.

Për sa i takon inxhinierit mekanik të kërkuar, është të nevojshëm për zbatimin e kontratës pasi inxhinieri mekanik do të ndjekin ecurinë e punimeve mekanikesi montime dhe demontime të pajisve dhe konstruksioneve mekanike të investimit.

2.3.9 Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar ose me kontrate shërbimi, mjekun e shoqërisë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë, sipas parashikimeve të VKM-se Nr.692 date 13.12.2001 ndryshuar me VKM Nr. 742 date 06.11.2003.

(Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këto kërkesa duke pasur në konsideratë edhe parashikimin e pikës 12/2 të VKM-se Nr. 692 date 13.12.2001, i ndryshuar).

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentim: Referuar ligjit Nr.10237 date 18.02.2010 për sigurinë dhe shëndetin në punë nëni 23 pika 1. Cdo kompani duhet të ketë të punësuar ose me kontrate shërbimi një mjek për ofrimin e shërbimit të mjekut të kompanisë. Për arsye të organizimit dhe monitorimit të veprimtarisë së sigurisë dhe shëndetit në punë, kontrollin /inspektimin periodik për gjendjen e masave mbrojtëse në punë dhe zbatimin e rregullores së sigurisë dhe shëndetit në punë nga të gjithë punonjësit.

Trajnime për punonjësit për dheninë e ndihmës së parë apo shmangien e reziqeve që mund të ekzpozohen punonjësit.

Ndjeka dhe analizimi i të dhenave në lidhje me aksidentet në punë apo semundjet profesionale.

2.3.10 Per listën e mëposhtme të mallrave:

- Transformatori i Fuqisë
- Monitorim izolacioni BMT për transformator fuqie
- Çelezi 110 kV
- Ndaresi 110 kV
- TR Rryme 110 kV
- Panele kontrolli
- Panele mbrojtje
- Çelat TM

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

1. *Autorizim te prodhuesit/ve/distributorit te autorizuar per listen e mesiperme te mallrave. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.*
2. *Katalog/et ose fragmente te katalogut/eve te prodhuesit/per listen e materialeve te mesiperme qe do te ofrohen, ne te cilen te paraqiten te dhenat teknike baze te perkthyer ne gjuhen shqipe.*
Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet te tregojne lehtesisht dhe qarte qe jane pjese katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.
3. *Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese deshmi te testimave zyrtare te kryera, te leshuara nga institucione te autorizuar ose nga prodhuesi te kryera me pare, qe vertetojne pajtueshmerine e materialeve te prodhuara (lista e mesiperme ose te ngjashme) me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara.*

Argumentim: Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standartet IEC/EN/SSH. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisës së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Operatori Ekonomik ofertues duhet te paraqese deshmi te testimave (type test ose rutine test) zyrtare te kryera per mallrat objekt prokurimi, te leshuara nga institucione te autorizuar ose nga prodhuesi.

Shenim: Testet duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe.

Argumentim: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Duke marrë parasysh që e gjithë lista e kërkuar përbehet nga pajisje të vecanta që përdoren në N/stacione elektrike, kërkohet nga prodhuesi që të deshmohet se është prodhues i certifikuar nga institucione ndërkombëtare sipas standardeve IEC/EN/SSH. Kriteri i kërkuar në lidhje me testet tip ose rutine të produkteve të kerkuara nga prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me pikën 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Operatori Ekonomik ofertues duhet te paraqese: Katalogun/et ose fragmente te katalogut/eve te prodhuesit/ve per listen e mallrave objekt prokurimi, ne te cilet te tregohen dhe te specifikohen qarte materialet qe do te ofrohen.

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet te tregojne lehtesisht dhe qarte qe jane pjese katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin. Gjithashtu katalogu duhet te jete ne gjuhen shqipe.

Argumentim: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Gjithashtu për te siguruar që pajisjet që do të furnizohen nga Operatori ekonomik, janë të prodhuara nga prodhues të njohur dhe të pranuar sipas standarteve nderkombetare IEC/EN/SSH. Kriteri I kerkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me piken 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij të paktën 1 (Një) Inxhinier të certifikuar nga prodhuesi/ekuivalent për instalimin dhe komisionimin pajisjeve monitoruese BMT (Monitorimi i Izolatorëve të Transformatorit), i cili do të realizojë këtë shërbim.

Për të provuar plotësimin e këtij kushti duhet të paraqitet:

- Kontrata e punës/ose shërbimi
- Liste pagesat.
- Certifikata përkatëse e Inxhinierit të certifikuar nga prodhuesi ose ekuivalente i pajisjeve monitoruese BMT (Monitorimi i Izolatorëve të Transformatorit), i cili do të realizojë këtë shërbim.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentim: Kërkesa për të patur në staf teknik 1 inxhinier i certifikuar nga prodhues/ose ekuivalent i Monitorimi i Izolatorëve të Transformatorit që paraqiten në transformatorët e fuqisë në N/stacionin elektrike është kërkuar nga ana jone sipas natyres së punës e cila është me instalimin dhe komisionimin & konfigurimin e setit të monitorimit online të transformatorëve të fuqisë me BMT. Është natyrë pune e cile kërkon specialist të certifikuar dhe në nivel të lartë profesional për venien në funksion të pajisjeve të monitorimit online BMT të transformatorëve të ri që do të furnizojnë në N/stacionin Corovode. Ky kriter është

në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisës së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

1. Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se dispononë liçense profesionale për zbatim punimesh në ndertim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar.

2.3.12 Liçensa profesionale e shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:
Punime të përgjithshme ndertimi:

<u>Kategoria NP-1</u>	Punime gërmimi në tokë	Klasifikim B
<u>Kategoria NP-2</u>	Ndertime civile dhe industriale	Klasifikim C
<u>Kategoria NP-11</u>	Ndertime për N/stacionet, kabinat e transformatorve, linjat TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë	Klasifikim B
<u>Kategoria NS-14</u>	Impiante të brendëshme, elektrike, telefoni, etj.	Klasifikimi A
<u>Kategoria NS-18</u>	Punime topogjeodezike.	Klasifikimi A

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë liçensat profesionale sipas zërave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr përsipër të realizojë).

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të liçencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarohet se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik. Certifikimet/diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “regjistrat profesionale” të AKAFP-se.

2.3.14 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Certifikatat ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- a) ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;
- b) ISO 14001: 2015 "Sistemi i menaxhimit të mjedisit";
- c) ISO 45001: 2018 "Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë" .

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtare, i cili parashton kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.3.15 Operatori ekonomik duhet te kete në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike te nevojshme per ekzekutimin e kontrates, si me poshte (sipas formularit permbledhes te vetedeklarimit):

Nr.	Pershkrimi i mjetit	Sasia	Gjendja
1.	Autobetoniere ≥ 3.5 m ³ per punime ne kantier	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
2.	Pompe per hedhje betoni	1 (nje) copë	Pronësi ose me qera
3.	Kamion transportues mbi 5 ton vete shkarkues me Vinc	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
4.	Automjet tip pick up për transportin e stafit ne kantier	2(dy) cope	Pronësi ose me qera
5.	Vinç mbi ose 150 ton	1(një) copë	Pronësi ose me qera
6.	Eskavator	1(nje) copë	Pronësi ose me qera

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

7.	Miniekskavator me zinxhir gome	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
8.	Fadrome	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
9.	Gjysmë rimorkio për transportin e automjeteve me zinxhirë dhe kontiniereve.	1(nje) cope	Pronësi ose me qera
10.	Rrul ngjeshes	1 (nje) cope	Pronësi ose me qera
11.	Matrapik Dore	2(dy) cope	Pronësi ose me qera
12.	Saldatrice	1(nje) cope	Pronësi ose me qera

Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike ne pronesi/qira do të paraqiten keto dokumenta:

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit: çertifikatën e pronësisë; leja e qarkullimit; çertifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; lejen e transportit që lëshohet nga njësia vendore dhe fotot përkatëse;
Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot, ndërsa për mjetet e marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- c) Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme eshte vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nepermjet ketyre kerkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kane në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qellim permbushjen me sukses te kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit

Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”, sjellim ne vemendje se:

- Disponimi i punonjësve dhe i mjeteve/pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit gjatë fazes së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara fazes së nenshkrimit të kontratës do t’i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit për disponimin e punonjësve, mjeteve/pajisjeve do të jetë kusht s’kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s’kualifikimi.

SHENIM: Ne funksion te plotesimit te Shtojces 8 “Formulari permbledhes i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin/Administratoret e shoqerise, Ortakun/Ortaket e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise, perfshire ato teknike.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Bazuar në shkresën e ardhur nga grupi i punës i ngritur me nr prot 801/1 datë: 30.08.2023 “Për përlllogaritjrn e fondit limit”, ku bashkëlidhur kanë sjellë në sektorin e prokurimeve, specifikimet teknike objekt prokurimi. Specifikimet teknike të dërguara, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të ligjit **nr.162/2020, datë 23.12.2020** “Për Prokurimin publik”, dhe nenin 39 pika 2 të Vendimin e Këshillit të Ministrave **Nr. 285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, njësia e prokurimit kreu miratimin e specifikimeve teknike objekt prokurimi.

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

Njësia e Prokurimit bëri llogaritjen e afateve dhe vendosi që duke filluar nga data e hedhjes në sistem data e fundit e pranimit të ofertave dhe e zhvillimit të prokurimit të jetë data 21.09.2023.

Personi i autorizuar për të ngarkuar në sistem DST dhe gjithë dokumentat e tenderit do të jetë Z. Aleksandër Pjetri.

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

❖ Njesia e Prokurimit